



MINISTRI HASANI NË KORENË E JUGUT: MUNDËSI E SHKËLQYER PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT

Gjatë vizitës zyrtare në Republikën e Koresës, MEPJ Igli Hasani u prit në një takim nga Ministri për Punët e Jashtme, Cho Tae-yul. Dy zyrtarët shprehën angazhimin e përbashkët për intensifikimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe zgjerimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme. Në vizitën e tij në kompaninë 'Yura Corporation', Ministri Hasani nënvizoi se dega e Yura-s në Shqipëri është një provë e mjedisit tonë miqësor ndaj biznesit për investimet e huaja direkte. Gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Koresës, MEPJ Igli Hasani zhvilloi takime me Zëvendës Presidentin e Çështjeve Ndërkombëtare të Shoqatës Ndërkombëtare të Tregtisë së Koresës, Gi-Hyun Kim, si dhe me drejtues të grupit parlamentar të miqësisë Shqipëri – Kore e Jugut. Në ditën e fundit të vizitës, kryediplomati shqiptar Hasani nënshkroi memorandumun e mirëkuptimit mes Akademisë Diplomatike të Shqipërisë dhe asaj të Koresës. I ftuar për të dhënë leksion në Akademinë Diplomatike Kombëtare të Koresës, Ministri Hasani foli për sfidat e rajonit të Ballkanit Perëndimor, integrimin në BE dhe rolin e Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit në rajon.

MINISTRI HASANI: TË RIVLERËSOHET QËNDRIMI PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË NISMAT RAJONALE

MPEJ Igli Hasani, mirëpriti në një takim në MEPJ, Ministrin e Punëve të Jashtme të Bosnje dhe Hercegovinës, Elmedin Konakovic. Dy homologët shprehën vullnetin e të dyja palëve për intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe në fushat me interes të përbashkët. Për një bashkëpunim rajonal më të suksesshëm, Ministri Hasani u shpreh se Kosova duhet të këqyret në një optikë bashkëkohore, realiste e pragmatike.

HASANI: MARRËDHËNIET DYPALËSHE SHQIPËRI-JAPONI PO PËRPAROJNË ME RITME TË SHPEJTA

MPEJ Igli Hasani zhvilloi një takim me Kryetarin e Komisionit të Përhershëm për Punët e Jashtme, Takaaki Katsumata dhe Grupin Parlamentar të Japonisë. Ministri Hasani theksoi se dinamika e fundit në shkëmbimin e vizitave të nivelit të lartë ndërmjet Shqipërisë dhe Japonisë tregon qartë se sa shpejt po përparojnë marrëdhëniet dypalëshe mes dy vendeve. Të dyja palët shprehën vullnet për të rritur shkëmbimet e nivelit të lartë dypalësh dhe dialogun politik për të siguruar shkëmbim pikëpamjesh dhe koordinim efikas për çështje me interes të ndërsjellë.

SHQIPËRI-KINË, HASANI: VULLNET PËR INTENSIFIKIMIN E MËTEJSHËM TË MARRËDHËNIEVE DYPALËSHE

MEPJ Igli Hasani priti në një takim të Dërguarin e Posaçëm të Qeverisë kineze për Çështjet Evropiane, Wu Hongbo. Bashkëbiseduesit vlerësuan angazhimin dypalësh për të punuar së bashku, për forcimin e marrëdhënieve, bashkëpunimin dypalësh dhe atë shumëpalësh në fusha me interes të përbashkët dhe atë global. Palët ripohuan rëndësinë e rritjes së shkëmbimeve mes popujve, si një bazë që nxit mirëkuptimin dhe besimin e ndërsjellë për të ardhmen dhe shërben si katalizator për gjenerimin e zgjidhjeve dhe adresimin e sfidave.

KRYESIA SHQIPTARE E CEI, MINISTRI HASANI: JO MË VONESA PËR INTEGRIMIN E RAJONIT

MEPJ Igli Hasani mori pjesë në takimin e Komitetit Parlamentar të Nismës së Evropës Qendrore (CEI), që u mbajt në Tiranë, në kuadër të kryesisë së palës shqiptare. Ministri Hasani vlerësoi punën e deritanishme të CEI në mbështetje të Ballkanit Perëndimor, teksa theksoi nevojën urgjente për përshejtimin e procesit integruar të rajonit. Kryediplomati shqiptar u shpreh se Shqipëria e konsideron CEI-n një platformë pro aktive të bashkëpunimit rajonal, teksa nënvizoi se vendi ynë ka qenë dhe vazhdon të jetë një prej promotoreve të paepura lidhur me çdo propozim e projekt të kësaj nisme.

NATO, HASANI: SHQIPËRIA E PËRKUSHTUAR NDAJ AGJENDËS "GRATË, PAQJA DHE SIGURIA"

MEPJ Igli Hasani mori pjesë në punimet e Samitit të NATO-s në Uashington, pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga Kryeministri Edi Rama. Në takimin "Gratë, Paqja dhe Siguria", në nisje të samitit të NATO-s, Ministri Hasani ritheksoi se Shqipëria është plotësisht e përkushtuar në rritjen e përgjegjshmërisë në lidhje me agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria (WPS). Gjatë punimeve të Samitit, Ministri Hasani zhvilloi takime dypalëshe me homologët spanjoll, portugez, polak, sllovak etj, në fokus të së cilave ishte forcimi i bashkëpunimit dypalësh e shumëpalësh dhe integrimi i Shqipërisë dhe rajonit në BE.

KRYESIA SHQIPTARE E SEECP-SË, MBAHET NË TIRANË TAKIMI I DREJTORËVE POLITIKË

Në datën 10 korrik 2024, u mbajt në Tiranë takimi i Drejtorëve Politikë të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), në kuadër të presidencës shqiptare të kësaj nisme. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan prioritetet dhe kalendari i aktiviteteve që do të organizojë pala shqiptare përgjatë kësaj periudhe 1-vjeçare në krye të SEECP-së. Këto prioritete përfshijnë: Integrimin evropian; Bashkëpunimin në fushën e sigurisë; Zhvillimin ekonomik; Turizmin dhe kulturën; Transportin; Bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë etj.

PËRMBYLLET ME SUKSES PROGRAMI I PRAKTIKËS SË STUDENTËVE PRANË MEPJ

Me nismën dhe kujdesin e MEPJ Igli Hasani, për gati tre muaj, është zhvilluar një praktikë pune për të rejtat dhe të rinjtë e interesuar të provojnë dhe thellojnë dijet dhe aftësitë pranë shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Me rastin e përfundimit të suksesshëm të kësaj praktike, u zhvillua një ceremoni kushtuar certifikimit të praktikantëve, ku morën pjesë Ministri Hasani dhe nëpunësit e institucionit.